



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 10 maj 2018, në mbledhjen e II-rë (dytë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica dhe Floretë Zejnullahu, përveç këshilltares Fatlume Jaha e cila mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Gëzim Namani, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, dhe Driton Nuli përfaqësues i OSBE-së

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, i njoftoj për pikat e rendit të propozuar të ditës, dhe shtoi, nëse ndokush prej anëtarëve keni diçka rreth rendit të propozuar të ditës, urdhëroni nëse jo atëherë e hedh në votim sipas materialit të dërguar.

Pas votimit u konstatua se rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

1. Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 27 mars 2018

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet ky Ekstrakt u miratua njëzëri

2. Raporti Financiar për periudhën janar – mars 2018

z.Fatmir Gashi, Kryesues, fillimisht fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

z.Isuf Latifi, paraqiti fjalën e hyrjes. Theksoi, raporti pasqyron gjendjen financiare të të hyrave dhe shpenzimeve të Komunës për periudhën raportuese. Drejtori foli për shumën e mjeteve të shpenzuara nëpër kategoritë ekonomike. Nënvizoi këto janë shpenzimet e planifikuara, por janë përfshirë edhe shpenzimet faturat e të cilave kanë arrite me vonesë, fjala është për faturat e muajit dhjetor 2017 të cilat janë bartur në vitin 2018. Këto shpenzime janë reale dhe pasqyrojnë gjendjen e këtij tremujori. Drejtori pasqyroj edhe gjendjen e të hyrave vetanake për këtë periudhë duke theksuar vërejtjet dhe shqetësimet për shkak të pamundësisë së arkëtimit të pjesës së planifikuar të të hyrave vetanake. Shtoi, sigurisht këtu ka ndikuar edhe periudha e dimrit të ekonomitë familjare dhe të bizneset, por duhet të mendojmë që këto të hyra në periudhën e ardhshme të rriten. Këtu ndikon edhe Ministria e Financave e cila gjatë procesit të planifikimit, ka bërë rritjen e planifikimit të të hyrave dhe nga kjo rezulton se nuk kemi qenë real në planifikim. Ngjashëm situata e të hyrave pritet të jetë edhe për vitin 2019, sepse së paku prej 110,000 kanë shtuar nivelin e planifikimit të të hyrave në bazë të parametrave që ne i kemi dërguar me kohë.

z.Avni Fetahu, theksoi, raporti financiar është sjellë me kohë dhe pasqyrohet një gjendje reale faktike për një përdhë të caktuar kohore. Në Grup i këshilltarëve të LDK-së i rekomandojmë Kuvendit të Komunës për diskutim.

z.Fitim Haziri, vërejtjet dhe pikëpamjet tona lidhur me Raportin do t'i paraqesim nesër në mbledhjen e Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Raportin financiar e rekomandojmë për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

z.Mehmet Gashi, theksoi, të dhënat lidhur me raportin i sqaroi shumë mirë Drejtori i DBF dhe ne i rekomandojmë Kuvendit për miratim. Është bërë një praktikë e mirë e raportimeve tremujore. Drejtoria paraqet raportin real të shpenzimeve dhe të hyrave. Sikurse e theksoi Drejtori kur është fjala për të hyrat në muajt vijues, duhet pasur kujdes në funksion të realizimit të planit. Sa i përket shpenzimeve, jeni në dijeni se rreth 25% e buxhetit shpenzohet te kategoria e Pagave, Mallrave dhe Shërbimeve, Shërbimeve komunale, ndërsa të investimet kapitale në tremujorin e parë çdo herë ka pas një shpenzim të ultë për shkak se procedurat e prokurimit fillojnë në këtë periudhë dhe punimet nuk mund të kryhen në tremujorin e parë, kështu që shpenzimet kapitale në muajt në vijim paraqiten në shkallë më të lartë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, meqë nuk ka diskutime tjera Raportin e hedh në votim.

Me 6 vota për, 2 vota të përmbajtura dhe asnjë votë kundër, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

3. Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB

z.Avni Fetahu, theksoi, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi themelohet në kuadër të autorizimeve ligjore, me Udhëzimin Administrativ përkatës. KKSB merret me punë dhe aktivitete si dhe sjell rekomandime të ndryshe nga fusha e sigurisë publike në Komunën e Podujevës.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, jemi kundër kësaj pike të rendit të ditës për shkak të emrave të propozuar në KKSB. E propozuara Donjeta Sheqiri nuk i takon ndonjë OJQ-je dhe po ashtu ka qenë kandidat për Asambleen komunale nga radhët e LDK-së, pastaj për Radisav Perović, nuk kemi njohuri se a është banor i Komunës së Podujevës. Më gjerësisht këto do t'i diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, KKSB-së është Këshill që përfshinë të gjitha fushat e sigurisë publike, si aksidentet në trafik, zjarret etje. Pasi që Kryetari i Komunës është në krye të Këshillit, ku janë të përfshirë edhe Komandanti i Stacionit të Policisë dhe përfaqësues të subjekteve relevante në Komunë, nga Komandanti i Policisë do të ishte mirë që në të ardhmen të kemi një raport, fjala vjen në fushën e trafikut nga viti i kaluar të dimë numrin e aksidenteve, sepse po thuajse të gjitha aksidentet kanë ndodhur në akset rrugore të njëjta siç janë rruga në drejtim të fshatit Peran, magjistralja, pastaj udhëkryqi në fshatrat Lladoc–Balloc afër fshatit Sfeçël etj. dhe ne si Kuvend të japim kontributin tonë në këtë aspekt, se çfarë preventivash duhet ndërmarrë. Pra të kemi një raport dhe të dimë prej viti në vit KKSB se cilat preventiva do të ndërmarrë, në mënyrë që të kemi një siguri më të madhe. Megjithatë, është mirë që në Komunën tonë nuk ka ndonjë fenomen shqetësues, megjithatë kërkesa është që sa më shumë të japin preventiva për siguri. Qëllimi i vetëm është që Këshilli të kryej punën sa më lehtë dhe të ndikoj në rënien e numrit çoftë të aksidenteve, zjarreve etj.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, për rëndësinë, obligimet dhe fushëveprimin e Këshillit ato veç se janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ përkatës. Kur jemi te rastet e aksidenteve në trafik , atëherë kur ju e konsideroni të nevojshme mund të ftojme Komandantin e Policisë që të na informoj për gjendjen e sigurisë në trafik, të dhëna të cilat janë të rëndësishme si për Kuvendin e Komunës ashtu edhe për qytetarë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj se si trupë e cila themelohet nga Kuvendi në funksion të transparencës dhe informimit është e nevojshme që brenda vitit të paraqet raport në mënyrë që edhe ne të jemi në rrjedha lidhur me përmirësimin e gjendjes, përndryshe e dimë se aksidentet në tërësi nuk mund të evitohen, por preventivat nga organet kompetente janë të domosdoshme. Në mbledhjet e këtij Këshilli, Komandanti i Policisë sigurisht se informon për akset rrugore më të rrezikuara, apo kur kemi të bëjmë me zjarret se në cilat zona janë shkaktuar etj. Është në dorën e këtij Këshilli që të ndërmarrë preventivat që të jemi të përgatitur në situata të caktuara. Fatmirësisht nuk kemi ndonjë rrezikshmëri të lartë, por përndryshe pas një periudhe prej 6 muajsh nëse edhe Këshilli e parashihet se situata nuk është duke lëvizur drejt përmirësimit apo ka rritje të numrit të aksidenteve ne mund të organizojmë mbajtjen e një debati të gjerë si me qytetarë ashtu edhe në Kuvend se çka mund të ndërmarrim. Unë nuk jam në dijeni për mandatin që shkoi, nga ky Këshill, sa ka qenë numri i aksidenteve, zjarreve, vërshimeve etj. KKSB-në si trupë e kemi obligative ta ngrisim, ndërsa përbërja e anëtarëve mbetet të debatohet dhe vendimi merret në Kuvend.

z.Faik Muçiqi, theksoi, unë dy mandate kam qenë anëtar i KKSB-së. Jemi në vonesë për formimin e përbërjes së re të KKSB-së për shkak të shtyrjes së themelimit të Komitetit për Komunitete, ku Kryesuesi i Komitetit është anëtar me automatizëm i këtij Këshilli. Vetëm desha të ju informoj se Këshilli në mbledhjen e parë pas formimit do të paraqes Planin e veprimit për këtë vit dhe Raportin e punës për vitin e kaluar. Ky është obligim ligjor dhe kjo formë është praktikuar. Ne duhet të përshpejtojmë punën që në seancën e ardhme të arrijmë me Planin e veprimit dhe Raportin.

z.Mehmet Gashi, theksoi, sa i përket anëtarëve të KKSB-së, numri më i madh i tyre vijnë sipas detyrës zyrtare që kanë. U përmend përfaqësuesi i komunitetit serb, ai është banorë i një lagjeje të quajtur Sekiraqa në fshatin Metergoc, janë vetëm 7 banorë të komunitetit serb, pra ai është banor i Komunës së Podujevës. Unë desha të shtoj edhe diçka, ne si Komitet për Politikë dhe Financa i kemi të parapara 12 mbledhje brenda vitit. Deri më tani kemi mbajtur vetëm dy mbledhje. Ka shumë tema që mund të shqyrtohen vetëm nga Komiteti për Politikë dhe Financa, siç kemi fjala vjen debatin me qytetarë rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore KAB-in. Pra nuk do të thotë që duhet të shkojmë paralelisht me mbledhjet e Kuvendit, në të ardhmen duhet ta kemi parasysh këtë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket numrit të mbledhjeve të KPF-së, konsideroj, fjala vjen nëse mbajmë vetëm një mbledhje brenda 6 muajsh por e kryejmë një punë me rëndësi, në interes të Komunës, është më e vlefshme sesa të mbajmë 12 mbledhje pa ndonjë rezultat, pra duhet të reflektoj interesi i përgjithshëm. Pra këto takime i mbajmë për të ofruar diçka për qytetarët sepse për ta edhe mbahen.

z.Mehmet Gashi, ne kemi Planin e punës së Kuvendit dhe mendoj se duhet t'i përmbahemi. Kur kemi një pikë të paraparë për shqyrtim në muajin e ardhshëm nuk mendoj se ka nevojë të thirrret mbledhje e jashtëzakonshme për atë pikë.

z.Fatmir Gashi, kryesues, theksoi, e kemi të miratuar Planin e punës së Kuvendit por nëse ka ndonjë pikë që është e nevojshme dhe në interes të përgjithshëm ne patjetër që do ta procedojmë për shqyrtim. Meqë nuk ka diskutime tjera Propozimin e vendimit e hedh në votim.

Me 6 vota për, 2 vota të përmbajtura dhe asnjë votë kundër, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

4. Propozim vendimi për dhënien e pronave së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS

z.Fatmir Gashi, kryesues, fjalën e hyrjes e ka z.Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

z.Abaz Llugaliu, theksoi, për shkak të zgjedhjeve të fundit dhe në pamundësi ligjore që në afatin jo më pak se 6 muaj nuk lejohet dhënia e pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë kështu që kanë arritur dhe grumbulluar një numër i madh i kërkesave të kësaj natyre, gjithsejtë 50 kërkesa prej KEDS-it, për vendosjen e trafostacioneve të energjisë elektrike. Sipas këtij Propozim vendimi përfitues do të jenë 20 lokalitete. Kjo shkon në bazë të planit të investimeve për zgjerimin dhe përforcimin e rrjetit të distribucionit. Drejtori foli gjerësisht duke sqaruar formën e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.

z.Avni Fetahu, nuk kam diçka për të shtuar nga ajo që theksoi Drejtori, i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim pasi që është edhe në dobi të qytetarëve dhe lokaliteteve.

z.Fitim Haziri, theksoi, ne anëtarët e subjektit politik LVV jemi kundër që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim. Këtë e bazojmë në atë sikurse e theksoi Drejtori se është kompani private dhe nuk e shohim të arsyeshme që t'i jepet një kompanie private pa kompensim prona e Komunës, pavarësisht që nga kjo përfitojnë qytetarët por këtu fiton edhe kompania. Këto ditë ka raste që lëndëve në prokurori për faktin se kësaj kompania i kanë dhënë hidrocentralin.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, është e vërtetë se në mandatin e kaluar kemi debatuar për çështjen e cekur nga parafolësit dhe në parim kemi marrë një vendim që të caktojmë një pagesë minimale për pronat e komunale të cilat kryesisht sillen prej 0.5 ari apo 1 ari për vendosjen e transformatorëve. Kemi vendos një shumë simbolike në emër të qirasë, mirëpo nuk ka funksionuar. Nga ana tjetër kemi pas shumë kërkesa nga qytetarët që t'i kalojmë këto, për arsye se, unë po flas në emrin tim dhe për fshatin tim, ka qenë një ndër rrjetet më të dobëta, nuk po flas ndoshta në nivel të Kosovës, por në pjesën më të madhe të territorit të Komunës dhe rrjetin më të dobët në nivel të Komunës. Kemi pasur vizita edhe nga mediat dhe televizionet, nuk po flas për riparimin që është bërë në aksin Shajkoc- Batllavë që ka arritur deri në Dyz me shtylla të betonit dhe kabëll të izoluar. Rryma në përgjithësi është shumë e dobët, po flas për fshatin tim, pa stabilizator nuk ka funksionuar aparatura. Është shumë e vërtetë se nëse kapaciteti rrymës nuk arrin në 220 volt nuk ka as të drejtë për tu faturuar rryma, por kjo nuk është në kompetencën tonë. Kemi qenë për aplikimin e pagesës në emër të qirasë, por prapë jemi kthyer që të mos pësojnë fshatarët

që jetojnë nëpër zona më të thella rurale, për shkak të një vendimi tonë. Mendoj që edhe pse nuk e kam në parim dhe gjithherë kam insistuar edhe në mbledhjet e Kuvendit që mos të dalim jashtë Komunës së Podujevës sepse jemi të zgjedhur të Komunës së Podujevës, ndërsa kur të zgjidhemi për Republikën i trajtojmë çështjet nacionale, mirëpo nuk jam në dijeni se sa e ka afatin distribuimi dhe sa do të qëndroj mirëmbajtja e rrjetit. Kam shikuar një Marrëveshje sepse kam qenë i interesuar dhe në një pasues theksohet se brenda një periudhe të caktuar nëse nuk i përmbush kërkesat e qytetarëve ekziston mundësia që Qeveria t'i marr të drejtën KEDS-it. Në pozitat që jemi këtë të drejtë nuk mund t'ia marrim por dua të theksoj se e kam përjetuar rëndë këtë gjendje atëherë kur shumë grumbullues të cilët bëjnë grumbullimin e agrumeve nëpër frigoriferë kanë pësuar dhe kjo nuk ka funksionuar për shkak të kapacitetit të dobët të energjisë elektrike. Unë personalisht i kam dërguar mediat te grumbulluesit. Tani kanë vendosur një transformator dhe kapaciteti i rrymës është rregulluar dhe kjo situatë ka ndikuar pozitivisht edhe te banorët tjerë. Në këtë kontekst ne duhet shikuar më larg. Në fund kemi nxjerrë në përfundim se këto prona nuk duhet të jepen në shfrytëzim afatgjatë por edhe në afatshkurtër 5 apo 10 vite nuk mund të jetë. Unë jam për t'i dhënë pronat në shfrytëzim por në afat të mesëm. Thjesht nuk jam në dijeni se a po i vendosin të gjithë ata transformatorë sipas kërkesave dhe planit të distribuimit. Kjo do të duhej mbikëqyrë, kisha pas dëshirë po të kisha kompetencë për të përcjellë punën e shtrirjes së rrjetit dhe vendosjen e trafostacioneve, se si po realizohet. Është fakt se në pjesën urbane gjendja e energjisë elektrike është më e mirë se sa në zonat rurale apo në periferi. Po flas konkretisht, nga pjesa e fshatit Shajkoc deri në fshatin Brainë rrymë nuk kemi pas. Unë realisht nuk dua të insistoj për ti ndërruar qëndrimin politik askujt, së paku e paraqes atë çka unë kam hasur për 4 vitet e kaluara për çështjen e energjisë elektrike në Komunën tonë dhe kjo më ka shtyrë. Drejtori z. Abaz Llugaliu është në dijeni për atë se unë pikërisht kam insistuar në Kuvend, e që janë edhe procesverbalet që së paku edhe me vetëm 5 cent të figuroj vlera simbolike e qirasë, mirëpo nuk ka pas ditë që nuk kam pranuar deri 40 telefonata nga banorët e lokaliteteve duke thënë po bllokojmë punën. Unë nuk sanksionoj politikisht. E përsëris kam shkuar në Prishtinë dhe kam ftuar gazetarët dhe i kam dërguar në fabrikën e grumbullimit të agrumeve me qëllim të senzibilizimit të kësaj çështjeje pasi që jemi keq në këtë aspekt, mirëpo e kam vërejtur se ai person punon duke u pranuar të gjithë fermerëve frutat dhe i deponon në frigorifer. Dua të theksoj se shkak i rrymës së dobët edhe pse është munduar të bëjë zgjidhje me pasqyra solare, nuk ka funksionuar, ka pas probleme të shumta, të gjithë fermerët kanë ardhur në situatë dhe i kanë hedhur frutat. Tani kanë transformator dhe gjendja është përmirësua, përndryshe i rekomandojmë Kuvendit si Komitet dhe anëtar i grupit të diskutoj këtë pikë, së paku edhe ashtu është vendimi i shumicës. Kërkoj nga përfaqësuesit e të gjitha subjekteve këtu që jemi që asnjëherë mos të marrim qëndrim si shkas i vendimeve të nivelit qendror, sepse ne këtu duhet të vendosim në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

Po të pyetsha KEDS-in do ta mbaja si kompani shtetërore, ky është qëndrim imi si anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa.

z.Fitim Haziri, theksoi, në momentin që kompania në fjalë përmes privatizimit ka fituar KEK-un atëherë ka edhe obligime ndaj qytetarëve. Obligim i vetëm ka qenë ripërtërija e rrjetit dhe furnizimi me energji elektrike të vazhdueshme dhe përderisa i ka këto obligime nuk mendoj se kompania do të ndalet në vendosjen e një trafotje kur ne i vendosim një shumë në emër të qirasë që realisht kemi të drejtë. Përderisa ajo realizon fitime prej qytetarëve atëherë është interes i saj të vendos trafot ku është paraparë dhe sipas nevojave të qytetarëve.

z.Rafet Llapashtica, ashtu është sikurse theksoi parafolësi, mirëpo në një farë forme, nuk po them në tërë Komunën, por që tani të jap pikat ku kanë qenë të pozicionuar transformatorët nga sistemi i kaluar, por duhet të bëjmë kalkulime, fjala vjen në zonën tonë rrjeti i energjisë elektrike ka ardhur në vitin 1978 dhe vetëm një problem KEK-u ka pasur në atë periudhë, heqjen e llambave me gaz dhe vendosjen e

llambës elektrike, nuk ka pasur shpenzim sepse nuk ka pasur as teknikë të bardhë. Ne duhet të përformojmë në bazë të nevojave, sepse sot pesë ekonomi familjare në një fshat harxhojnë më shumë energji elektrike sesa i tërë fshati që ka harxhuar në vitin 1978 dhe atëherë ka qenë vetëm një transformator në të fshatin Dyz. Dua të theksoj se për kompetenca që kam edhe reflektoj. Se a është vendimi i mirë apo i keq, unë e vlerësoj se a është në interes të vendit dhe atyre që jetojnë këtu dhe atëherë unë vendosi në mënyrë të pavarur. Çfarë duhet të bëjmë nëse KEDS-i nuk i vendos transformatorët sepse ne nuk e lejojmë, pra në këtë rast çfarë të bëjmë, a kemi alternativë. Është edhe kjo dilemë që duhet diskutuar, fjala vjen ne parashohim një shumë simbolike prej 5 cent në emër të qirasë, ndërsa KEDS deklarohej se me pagesë nuk hyn në marrëdhënie kontraktuese, pra ne nuk e miratojmë për vendosjen e transformatorëve dhe në këtë gjendje vazhdojmë deri më 2021 derisa ka mandat ky Kuvend dhe shtrohet pyetja se a kemi punuar drejtë apo jo.

znj.Arlinda Kadriu, theksoi, në shikim të parë duket në rregull kërkesa ndaj KEDS-it për të aplikuar pagesë, mirëpo me sa e dëgjova Drejtorin e DPKGJ prona edhe herave të tjera është dhënë pa pagesë, dmth. atëherë shtrohet pyetja kush po dëmtohet në këtë rast, përgjigja është se po dëmtohen qytetarët e Komunës së Podujevës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, KEDS-i është kompani private dhe i vetmi furnitor i energjisë elektrike. Në këtë rast nuk është privatizua KEK-u por Rrjeti i Mirëmbajtjes dhe i Furnizimit me Energji Elektrike. Çështja është se ky vendim duhet të merret nga ne dhe ne duhet të përcaktohem, ta lëmë gjendjen kështu siç është deri në përfundim të vitit 2021 kur na përfundon edhe mandati apo të vendosim për ripërtëritje të rrjetit.

z.Abaz Llugaliu, theksoi, sa për sqarim, prona komunale që është propozuar për dhënie në shfrytëzim afatgjatë KEDS-it, është në sipërfaqe të përgjithshme prej 3 ari e 38m² dhe atë për vendosje të 34 trafostacioneve të energjisë elektrike dhe këto të shpërndara rreth 9 m². Numri më i madh i trafove vendosen në rrugë publike. Unë e kam parë Marrëveshjen e lidhur mes Qeverisë dhe KEDS-it dhe sipas saj asnjë trafostacion që e përmendi z. Rafet Llapashtica nuk është përfshirë në privatizim apo në shitje. Subjekti politik LVV, konkretisht Kryetari i Komunës së Prishtinës ngjashëm ka dhënë pronat e Komunës në shfrytëzim.

z.Fatmir Gashi, kryesues, meqë nuk ka diskutime tjera Propozimin e vendimit e hedh në votim.

Me 6 vota për, 2 vota të përmbajtura dhe asnjë votë kundër, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

5. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës (ish lokali i Shërbimit të Kontabilitetit Shoqërorë)

z.Fatmir Gashi, kryesues, fjalën e hyrjes e ka z. Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

z.Abaz Llugaliu, theksoi prona e cekur sipas këtij propozim vendimi do të jepet në shfrytëzim afatshkurtër prej 15 vitesh. Lokali ka qenë i dhënë në shfrytëzim por meqë sipas shfrytëzuesit ishte çmim i papërbalueshëm ai i ka përbush obligimet ndaj Komunës dhe ka kërkuar shkëputjen e kontratës dhe ajo është shkëputur. Gjatë hartimit të propozim vendimit janë lëshuar disa gabime teknike që duhet korrigjuar. Drejtori theksoi lëshimet dhe të njëjtat u evidentuan. Ndër tjera shtoi, Komisioni vlerësues është themeluar nga Kuvendi dhe i njëjti do caktoj edhe çmimin bazë fillestar për konkurrim.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne përkrahim këtë propozim vendim dhe rekomandojmë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Nënvizoi, Komisioni vlerësues në kuadër të autorizimeve ligjore do të zhvillojë

procedurën përkatëse. Dhënia në shfrytëzim e objektit është në interes për Komunën, siguron të hyra financiare.

z.Fitim Haziri, nuk kam diçka për të shtuar, i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim propozimin e vendimit për dhënie në shfrytëzim të objektit në pronësi të Komunës .

z.Rafet Llapashtica, sikurse e theksoi Drejtori objekti- lokali i cekur vitin e kaluar është dhënë në shfrytëzim me qira, e di se ka pasur një problem për shkak të ndarjes së lokalit pa leje dhe mbikëqyrjen komunale. Qiramarrësi ka hequr shtyllën kryesore të ndërtesës, pra ka qenë shumë pak serioz. Kam harruar për kohëzgjatjen e kontratës e cila sipas autorizimeve ligjore është nënshkruar nga Kryetari i Komunës. Mendoj se për tu hartuar një kontratë serioze institucionale duhet përfshirë edhe një pasues, kur kontrata shkëputet para afatit kontraktues pa ndonjë arsye, të sanksionohet. Unë nuk e kam parë kontratën por do të kërkoj prej Komisionit ta ketë kontratën e mëparshme që të njihet me arsyen e shkëputjes dhe se si fituesi i kontratës i ka eliminuar ofertuesit tjerë. Drejtori i DPKGJ duhet të na njoftoj se për këtë periudhë kohore a i ka shlyer obligimet qiramarrëse dhe obligimet tjera komunale si energji elektrike dhe ujë, sepse nuk duhet lejuar ti mbetet barrë Komunës. Kërkoj t'i bëhet një mbikëqyrje serioze përfituesit të ri të kontratës. Përndryshe, jam që ti jepet në shfrytëzim atij personi që pranon 20 persona në punë, e mbështesë edhe pa pagesë, sepse Komuna jonë ka nevojë për punësime të reja, ose nëse është e nevojshme edhe tre vite ta lirojmë pa pagesë nëse ai zhvillon një biznes dhe gjeneron vende pune. Jam për të dhënë lokalin me qira, paraprakisht të caktohet edhe një çmim bazë, pra të krijojmë për aplikues serioz. Pra çmimi duhet të jetë një çmim real, si çmim bazë nën të cilin nuk mund të ofertohet. Edhe unë jam për që propozim vendimi i cekur të rekomandohet për shqyrtim në Kuvend.

z.Fatmir Gashi, kryesues, meqë nuk ka diskutime tjera propozimin e vendimit e hedh në votim.

Njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim me plotësim ndryshim si vijon: “në pjesën e fundit të nenit 1 ku thuhet ngastra kadastrale 2858-0..” duhet të jetë “ i ndërtuar në njësinë kadastrale parcelë nr. 2858-0...”

6. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në fshatin Llapashticë e Poshtme

z.Fatmir Gashi, kryesues, fjalën e hyrjes e ka z. Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

z.Abaz Llugaliu, i njoftoi anëtarët e KPF-së për lokacionin e pronës dhe kohëzgjatjen e propozuar për dhënie në shfrytëzim. Gjithashtu theksoi edhe dy lëshime teknike nga materiali, të cilat u evidentuan për korrigjim.

z.Fatmir Gashi, kryesues, meqë nuk ka diskutime tjera Propozimin e vendimit e hedh në votim.

Njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim me plotësim ndryshim si vijon: fjalia pronë e Komunës “ e cila figuron në nenin 1, fshihet; si dhe fjala” dhënien “ e cila figuron në nenin 4 duhet të jetë ”dhe “.

7. Propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Ministrisë së Punëve të Brendshme

z.Fatmir Gashi, kryesues, fjalën e hyrjes e ka z. Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

z.Abaz Llugaliu, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës i referohet dispozitave për dhënien në shfrytëzim për raste të veçanta sepse kemi një kërkesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, fjala është për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës në sipërfaqe prej 50 m², për ndërtimin e një baze të pompimit të ujit për furnizim të pikës doganore në Merdare.

z.Avni Fetahu, theksoi, do të ishte shumë e domosdoshme për tu definuar çështja e kyçjes apo mos kyçjes së banorëve, sepse është e vërtetë se Dogana ka nevojë për furnizim me ujë por edhe një pjesë e madhe e fshatit Miroc por edhe e banorëve tjerë kanë nevojë për furnizim me ujë të pijshëm, kështu që mendoj se me atë kapacitet që do të ndërtohet aty do të ishte një mundësi e mirë edhe për banorët e lokalitetit pran.

z.Abaz Llugaliu, sa i përket diskutimit të parafolësit, për shqyrtimin e mundësisë për kyçje në rrjetin e ujësjellësit edhe të banorëve të lokalitetit afër, për këtë nuk mund të jap përgjigje.

z.Rafet Llapashtica, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, është çështje e ndjeshme dhe duhet mbështetur në të gjitha format. Sa i përket kërkesës së z. Avni Fetahut, mendoj se para se të merret vendimi është dashur të zhvilloheshin konsultat në mes Ekzekutivit të Komunës dhe MPB-së, në funksion të kyçjes së banorëve të fshatrave Merdare, Livadicë dhe Shtedim, për aq sa ka kapacitet, përndryshe nëse ua lejojmë sistemin e pompimit që në fakt po e lejojmë atëherë MPB do të ndërtoj sistemin vetëm për pikën doganore ndërsa qytetarët nuk i lejon të kyçen në atë sistem. Ju mund të bisedoni me banorët e interesuar për kyçje, nëse është e nevojshme ne mund të thërrasim edhe mbledhje të jashtëzakonshme për këtë çështje, përndryshe pas marrjes së vendimit për lejimin, ndërtimin e sistemit e bëjnë vetëm për degën doganore. Ne do të miratojmë kërkesën për lokacionin e kërkuar nga MPB, por edhe duhet t'i njoftojmë se kemi edhe një projekt bazë për sigurimin e ujit të pijes për banorët përreth dhe nëse është e mundur gjatë realizimit të projektit të arrijmë një marrëveshje, kështu që nga Ekzekutivi duhet bërë një kërkesë lidhur me çështjen e shtruar, për të përfituar nga projekti, sepse është në interes të banorëve dhe nga ana tjetër kanë edhe buxhet të mjaftueshëm.

z.Mehmet Gashi, theksoi si Komitet i rekomandojmë Kuvendit por edhe Kryetarit të Komunës që ta ketë parasysh këtë çështje, të cekur nga parafolësit, për gjetjen e mundësisë.

z.Fatmir Gashi, kryesues, meqë nuk ka diskutime tjera Propozimin e vendimit e hedh në votim.

Njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim

8. Propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Regjionale të Mbeturinave KRM "Pastrimi"

z.Fatmir Gashi, kryesues, fjalën e hyrjes e ka z. Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

z.Abaz Llugaliu, theksoi, dhënia në shfrytëzim Kompanisë Regjionale të Mbeturinave KRM "Pastrimi" është dhe interes i Komunës, sepse kjo kompani bartet jashtë qytetit, ngase në lokacionin aktual nga banorët përreth ka ankesa për shkak të kundërmimit. Fjala është për zhvendosje në lokacionin në fshatin Dumnicë e Poshtme në sipërfaqe prej 6000m², në propozim vendim është bërë një lëshim teknik, që do

të korrigojohet. Nga biseda me shefin e Njesisë së Kompanisë në Podujevë i njëjti ka konfirmuar se ekzistojnë mundësitë që Kompania Rajonale do të investoj në lokacionin e cekur për ndërtimin e objektit të ri për Kompaninë.

z.Avni Fetahu, kam një pyetje për Drejtorin, pasi që dihet se ka pas ankesa nga banorët për shkak të kundërmimit, a dihet për kohën se kur mund të bëhet bartja në atë lokacion dhe a parashihet me mbet aty diçka apo jo.

z.Abaz Llugaliu, fillimisht Kompania ka kërkuar t'i jepet në shfrytëzim parcela, ndërsa çështja e investimeve dhe ndërtimit është në tërësi e tyre. Sa i përket tërheqjes nga lokacioni aktual, ajo do të lirohet në tërësi dhe do të kaloj në lokacionin sipas propozim vendimit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0038657/18
Podujevë,
10 maj 2018

Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi